



Bisedë me Reshat Shabanin, kryetar i pensionistëve të Bogovinës

Për aktivitet, më shumë flasin numrat



Tashmë dy vite kryetar i degës është Reshat Shabani, arsimtar i pensionuar i grupit klasor. Për përditshmërinë e pensionistëve, për bashkëpunim dhe sfida të ngjashme flet kryetari Shabani

Pensionistët e pesë komunave rurale të rajonit të Tetovës janë të kyçur në Shoqatën e pensionistëve të Tetovës, kurse dega e Bogovinës me rreth 1.000 anëtarë vepron dhe i përfshinë të gjithë dhjetë fshatrat e komunës, të shtrira në Fushën e Pollog dhe në degët e Malit Sharr. Tashmë dy vite kryetar i degës është Reshat Shabani, arsimtar i pensionuar i grupit klasor. Për përditshmërinë e pensionistëve, për bashkëpunim dhe sfi-

da të ngjashme flet kryetari Shabani. "Më shumë pensionistë ka në Bogovinë, Pirok dhe Kamjan. Por, kjo nuk do të thotë se rajonet tjera i lëmë anash. Përkundrazi, në çdo fshat kemi së paku nga një aktivist i cili është i kyçur në këshillin e degës, i cili është një lloj koordinatori. Herë pas here edhe unë realizoj takime direkte, veçanërisht nëse bëhet fjalë për dëshirë të anëtarëve. Për aktivitet më shumë flasin numrat. Gjatë vitit të kaluar, njëqind pensionist morën pjesë në ekskursionet të ndryshme në vendin tonë dhe të fqinjët. SHP Tetovë vazhdimisht angazhohet anëtarët e saj të kalojnë pushimet në det. Në vitin 2016, deri në 50 pensionistë tanë kaluan pushimet në Durrës të

Shqipërisë fqinje, me shpenzime minimale. Kështu është 4-5 vite. Mes atyre që udhëtojnë ka dhe pensionistë të cilët për herë të parë kanë parë det. Në pjesën ku vepron Shoqata ka më shumë zona rurale me numër të madh të pensionistëve. Veçanërisht raport të mirë kemi me degët në Tearcë, Bërvenicë dhe Grupçin. Ajo kontribuon në shkëmbimin e përvojave. Interesant është edhe ajo se në dy vitet e fundit tre pensionistë tanë janë kyçur në ekipet për gara sportive, ndërsa ka fundi jemi me formimin e orkestrës tonë të cilën do ta përbëjnë aktivistët të gjajdes, kitarës dhe instrumenteve të tjera. Kjo është parakusht për kyçje më të madhe në shfaqjet e këngës, muzikë dhe lodra, që çdo vit mbahen, ndërsa

këtë vit Shoqata e jonë do të jetë nikoqir e shfaqjes rajonale. Gjithashtu, Komuna e Bogovinës është nënshkruese e marrëveshjes për bashkëpunim me SHP Tetovë. Prej aty dalin edhe disa marrëdhënie reciproke. Kjo veçanërisht ka të bëjë me mirëkuptim me kryetarin e komunës Hazbi Idrizi. Për disa tubime tona në dispozicion i kemi edhe hapësirat e komunës. Duke i'u falënderuar për këtë bashkëpunim atij, kemi hapur dhe kemi punuar me sukses në Klubin e pensionistëve në Bogovinë, për çka hasëm në mirëkuptim edhe tek pronari i lokalit Shaban Shaini. Me propozim të degës së paku dhjetë pensionistë në vit shfrytëzojnë ndihmë financiare të cilën e ndanë Shoqata.



Vazhdon projekti "Fondi më afër pensionistëve"

Drejtorët e FSSHM, Sasho Stefanovski dhe Orhan Ramadani kanë realizuar një vizitë pune në LSHPM ku kanë realizuar takim me kryetarin, Dragi Argirovski dhe bashkëpunëtorët e tij dhe Komisionin për shëndetësi dhe politikë sociale. Kjo është mënyrë e natyrshme e komunikimit dhe bashkëpunimit që praktikohet tani në vitin e pestë me radhë. Në takim është biseduar për shumë çështje nga sfera e mbrojtjes dhe sigurimit shëndetësor të pensionistëve. Një prej çështjeve ishte konkretizimi i aktiviteteve në projektin "Fondi më afër pensionistëve" për vitin 2017. Në takim është akorduar që të mbahen 30 punëtori edukative në shoqatat e pensionistëve. Projekti ka filluar në vitin 2014 në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe deri tani janë mbajtur 80 punëtori me rreth 5.000 pensionistë të cilët janë edukuar për masat preventive tek sëmundjet e caktuara dhe janë informuar për të drejtat e tyre. Pensionistët kanë shfaqur interesim të veçantë në lidhje me furnizimin me barëra refundim, pajisjeve ndihmëse ortopedike, si dhe për rehabilitimin e specializuar medicinal. Ky është projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm, kanë theksuar drejtorët e FS-

SHM, prandaj në mënyrë intensive do të realizohet edhe këtë vit për pensionistët, të cilët janë një prej kategorive më me numër të të siguruarve në Maqedoni. Kryetari Dragi Argirovski në takim mes tjerash ka theksuar se projekti "Fondi më afër pensionistëve" jep rezultate të shkëlqyeshme. Ai gjithashtu u ndal në disa tema që i interesojnë pensionistët, siç janë Ligji për sigurim shëndetësor, participimi për barërat, recetat dhe të tjera. "Tash më në vitin e tretë, të gjithë pensionistët të cilët kanë pension deri në 12.600 denarë kanë të drejtë në shërbim spitalor falas, ndërsa ajo për ata ka rëndësi të madhe. Përpjekjet tona janë që ky benefit të zgjerohet dhe të përfshijë një numër më të madh të pensionistëve", ka shtuar kryetari i LSHPM Argirovski. Në konferencën për shtyp, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, Argirovski mes tjerash potencoi se LSHPM mbetet në kërkesën që të ndërtohen shtëpi të reja për vendosje të pensionistëve dhe se Qeveria ka sjellë vendim për ndërtimin e shtëpisë së re të pensionistëve dhe të pleqve në Gazi Babë, ndërsa insistohet që të ndërtohen edhe në Koçan, Shtip, Kërçovë, Ohër, Kavadar dhe vende të tjera.

Vit i suksesshëm për pensionistët e Sarajit



Shoqata e pensionistëve të komunës së Sarajit më datë 14.03.2017 ka mbajtur Kuvendin vjetor ku është paraqitur Raporti për punën e shoqatës në vitin 2016. Kryetari i Kuvendit Baki Bakiu ka theksuar për punën e Kuvendit, aktiviteteve sportive, ekskursioneve, verimit, ndihmën e pensionistëve me pensione të ulëta, informimin, Aktivin e grave të pensionistëve, punën e nëndegëve, Raportin financiar, Këshillin mbikëqyrës etj. Theks të veçantë i dha Qendrës së re ditore të

porsahapur për qëndrim të personave të moshuar – klubin e pensionistëve ku në bashkëpunim me Kryqin e kuq organizohen dhe realizohen aktivitete të ndryshme në dobi të pensionistëve. Kryetari i Këshillit ekzekutiv të Shoqatës, Mahir Duraku, mes tjerash theksoi edhe për zgjedhjen e kryetarit të ri të K. E – Shoqatës, zgjedhjen e sekretarit, punën në lidhje me ndryshimet dhe plotësimin e Statutit, Programet e Komisionit, pjesëmarrjen në garat sportive, të Revialit etj.

Punën e Kuvendit e përsëritën dhe me diskutimet e tyre kontribuan mysafirët prezent: kryetari i KE i SHP Tetovë, Shaban Azizi, kryetari i SHP Gostivar Nijazi Xhelili, kryetari i KE të SHP Gjorçe Petrov, njëkohësisht edhe kryetari i KE të LSHP të Qytetit të Shkupit, Metodija Novkovski, përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, Tihana Obradoviç dhe kryetari i Këshillit drejtues të Fondacionit "Albiz", Besim Dauti, si dhe Dr. Jovan Deçkov, kryetar i Komisionit për shëndet dhe çështje sociale pranë shoqatës.

Të gjitha dokumentet e futura rend të ditës: Raporti i punës, Raporti financiar, Llogaria përfundimtare, Raporti i Këshillit mbikëqyrës për vitin 2016, si dhe Raporti financiar dhe Programi për punë të shoqatës për vitin 2017, pas shqyrtimit janë miratuar njëzëri nga ana e Kuvendit.

Sukses i vazhdueshëm i grupit muzikor nga Struga



Grup i përzier muzikor pranë SHP Strugë më shumë se shtatë vjet ka funksionuar me sukses, duke sjellë disponim tek struganët dhe pensionistët struganë. Sipas kryetarit të shoqatës Milorad Trposki, grupi muzikor është formuar me iniciativë të tij dhe të kryetares të Aktivit të pensionistëve Elisaveta Llazareska dhe aktivistes Nadezhda Çotorshkovska. Këngët që janë krijuar me kalimin e kohës, sot konsiderohen si tradicionale, ndërsa në repertorin e grupit janë dhe këngët: "Në Strugë dyqan

të kem", "Në mes të Strugës rrjedh Drini", "Dashurova, dashurova", "Vajzë, vajzë" etj. "Këngët e mësoja nga shumë njerëz, ndërsa disa nga gjyshja dhe nëna ime. Dhe ashtu i di të gjithë këngët e vjetra tradicionale strugane. Tashmë 50 vite jam me muzikën dhe atë e kemi në shpirt e gjithë familja", thotë Zdravko Stefanoski, i cili me gruan e tij Roza janë në pjesë e grupit që nga themelimi. "Në Strugë, në vitet e gjashtëdhjeta kishte tjetër përbërje 'Struganë duke kënduar', ndërsa tani jemi

vetëm ne", thonë këngëtarët Ljuba dhe Krste Jovanoski. "Aktivi i pensionistëve nën udhëheqjen e Elisaveta Llazareska ka përparësi edhe në suksesin e grupit muzikor. Përmes veprimit të saj vjen në shprehje masiviteti i pensionistëve, larmia e aktiviteteve, zgjerimi i bashkëpunimit me organizata të ndryshme joqeveritare etj. "Për këtë, Aktivi ka mbështetje materiale dhe financiare nga shoqata", theksoi kryetari i Shoqatës Millodrag Trposki dhe Sekretari Izeir Mustafai.